

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 054-1

KLASA E ORIENTUAR KAH NXËNËSI (KLASAT 1-5)

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Programi i trajnimit “Klasa e orientuar kah nxënësi” është zhvilluar nga KEC për të mbështetur mësimdhënësit e arsimit fillor në krijimin e një mjedisi mësimor që vendos nxënësin në qendër të procesit të të nxënës. Trajnimi fokusohet në organizimin dhe menaxhimin e klasës në përputhje me nevojat, interesat dhe potencialin e nxënësve, duke nxitur zhvillimin e kompetencave dhe shkathtësive të shekullit XXI përmes praktikave bashkëkohore të mësimdhënies.

Qëllimet e Programit:

Programi i trajnimit “Klasa e orientuar kah nxënësi” ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të shkollave të Kosovës. Ky trajnim u ndihmon mësimdhënësve të klasave fillore të zhvillojnë shkathtësitë e rregullimit të ambientit mësimor me qëllim që të bëhet më i përshtatshëm dhe më nxitës për nxënësit.

Rezultatet e të nxënës

Pas përfundimit të këtij programi trajnimi, pjesëmarrësit do të:

- Kenë njohuri për mësimdhënien e orientuar kah nxënësit duke iu përshtatur nevojave, aftësive dhe interesave të tyre;
- Kuptojnë rëndësinë e lojës dhe argëtimit gjatë procesit të mësimi që ka për qëllim t’u mundësojë nxënësve pjesëmarrje aktive;
- Kenë njohuri për menaxhimin e klasës që përfshin: rregullimin e ambientit me qendra të aktiviteteve, planifikimin e punës duke u bazuar në Kurrikulën Kombëtare të Kosovës dhe planifikimet lëndore, klimën pozitive, etj.;
- Kenë njohuri për format e ndryshme të vlerësimit për nxënie që ndikojnë në zhvillimin e aftësive akademike dhe vetëbesimit të nxënësit me qëllim të ngritjes së performancës së tyre;
- Kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit të familjes me komunitetin si dhe të planifikojnë strategji për intensifikimin e këtij bashkëpunimi;
- Kenë ide se si t’i shfrytëzojnë materialet ricikluese si mjete pune në klasë.

Përmbajtja e trajnimit dhe forma e zbatimit

Programi i trajnimit “Klasa e orientuar kah nxënësi” zhvillohet në dy faza:

1. Trajnimi treditor (18 orë)

Trajnimi treditor zbatohet nga trajnerë të aftësuar dhe certifikuar nga KEC. KEC do të sigurojë edhe materialet e duhura, dhe mjetet didaktike për zbatimin e trajnimit. Dy ditët e para mbahen radhazi, ndërsa

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 2

dita e tretë realizohet, pas një muaji, pasi që mësime të mësimdhënës të kenë realizuar “Planin e veprimit të rregullimit të klasës”. Një pjesë e ditës të tretë i dedikohet prezantimeve të këtyre planeve. Për këtë trajnim treditësh, me katër sesione gjatë ditës, mësime të mësimdhënës kanë obligim të vijnë në paku 90% të kohës, në mënyrë që të fitojnë certifikatën.

2. Zbatimi i njohurive të reja, në formë të aktiviteteve në klasë (6 orë)

Njohuritë nga trajnimi treditësh zbatohen nga mësime të mësimdhënës përmes aktiviteteve të realizuara në klasë. Për këtë qëllim, programi siguron një set me materiale të duhura dhe literaturë për ndihmesën e zbatimit të aktiviteteve të programit të trajnimit në klasa. Gjatë kësaj periudhe mësime të mësimdhënës realizojnë “Planin e veprimit të rregullimit të klasës”. Ndryshimet e bëra në klasa përfshijnë: mjedisin e ndryshuar dhe të përmirësuar në klasë, pjesëmarrësit në këtë proces, krijimin e komunitetit të nxënësve të klasës, bashkëpunimin me familje dhe komunitet, menaxhimin e klasës, përdorimin e lojërave për mësim, planifikimin, etj. Si dëshmi, mësime të mësimdhënës duhet të përgatisin edhe dosjen e punës profesionale të tyre, ku përfshihet edhe plani i veprimit të gjithë procesit mësimor.

Temat që trajtohen gjatë trajnimit janë: menaxhimi i klasës; krijimi i komunitetit të klasës; bashkëpunimi i shkollës me familjen dhe komunitetin; prezantimi i planit dhe i obligimeve për rregullimin e klasës; mësimi i diferencuar; ndikimi i lojës në të nxënë; vlerësimi i të nxënë; si dhe planifikimi i një dite pune përmes integritetit të lëndëve në një temë të përbashkët.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësime të mësimdhënësve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, dhe pedagogëve.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi ë realizohet me anë të një trajnimi 3 ditor dhe punës praktike në klasë që përfshin gjithsej 24 orë. Nga 24 orë trajnimi, 18 do të organizohen përmes trajnimit të drejtpërdrejt, ndërsa 6 orë do të jenë detyra/ punë praktike të cilat do të zbatohen në klasë.

Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen për gjithsej 24 orë. Numri i përgjithshëm i orëve të trajnimit përfshin orët e trajnimit treditësh dhe aktivitetet për realizimin e “Planit të veprimit për rregullimin e klasës”, përkatësisht 18 orë trajnim dhe 6 orë zhvillim profesional përmes punës në shkollë.

Kusht për certifikim është pjesëmarrja në së paku 90% të trajnimit, realizimi i “Planit të veprimit”, prezantimi i tij gjatë ditës së tretë të trajnimit dhe përgatitja e dosjes profesionale.